



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

DREJTORIA E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË

RAPORT MBI ANKETIMIN STUDENTOR PËR VITIN AKADEMIK 2018-2019 (SEM. I)

Universiteti Politeknik i Tiranës - Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë

HYRJE

Ky raport anketimi është hartuar duke u bazuar në **Ligjin 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”**, si dhe në kuadër të zhvillimit të përgjithshëm institucional të Universitetit Politeknik të Tiranës duke u mbështetur mbi rekomandimet e dala nga procesi i Akreditimit të Parë Institucional i përmbyllur në Prill 2017 me Vendim Nr.13, Dt. 07.04.2017 të Bordit të Akreditimit “Për Akreditimin e Parë të Institucionit të Arsimit të Lartë Universiteti Politeknik i Tiranës”.

Raporti ka analizuar të dhënat e përfuara nga anketimet e kryera në periudhën 2018-2019 (semestri i parë) në gjashtë Fakultete të Universitetit Politeknik:

1. Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës (FAU)
2. Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit (FIN)
3. Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike (FIE)
4. Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave (FGJM)
5. Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit (FTI)
6. Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike (FIMIF)

Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, për shkak të mungesës së një sistemi elektronik të sekretarisë mësimore ka realizuar procesin e anketimit përmes plotësimit manual të pyetësorëve (“paper based survey”). Përpara zhvillimit të provimit, pyetësorët e printuar janë shpërndarë tek studentët dhe pas plotësimit janë dorëzuar tek personeli përgjegjës i FIM.

Më poshtë pasqyrohen në mënyrë të detajuar të gjithë hapat e ndjekur për realizimin e procesit të anketimit, deri në gjenerimin e rezultateve dhe hartimin e përfundimeve.

PËRMBAJTJE	
HYRJE	1
1. BAZA LIGJORE	3
1.1. LIGJI I ARSIMIT TË LARTË	3
1.2. KODI I CILËSISË SË ARSIMIT TË LARTË.....	3
1.3. AKREDITIMI INSTITUCIONAL	4
2. ORGANIZIMI I PYETËSORIT	4
2.1. AVANTAZHET E SISTEMIT ELEKTRONIK	4
2.2. QËLLIMI I PYETËSORIT	5
2.3. HARTIMI I PYETJEVE DHE KRITERET E VLERËSIMIT	5
3. SISTEMI ELEKTRONIK I PYETËSORIT.....	6
3.1. GJENERIMI I TË DHËNAVE	10
3.2. ANONIMATI I STUDENTIT	11
4. REZULTATET E ANKETIMIT.....	11
4.1. METODOLOGJIA E PËRDORUR PËR ANALIZIMIN E TË DHËNAVE	11
4.2. PJESËMARRJA NË ANKETIM	12
5. EVIDENTIMI I PROBLEMATIKAVE NË RANG INSTITUCIONI.....	13
6. VLERËSIMET SIPAS FAKULTETEVE DHE PROGRAMEVE TË STUDIMIT	14
6.1. FAKULTETET PJESË E ANKETIMIT	14
6.2. PROGRAMET E STUDIMIT PJESË E ANKETIMIT	14
6.2.1. PËRCAKTIMI I ANKETIMEVE TË PAVLEFSHME	16
6.3. KRITERET E VLERËSIMIT SIPAS FAKULTETEVE/PROGRAMEVE TË STUDIMIT.....	16
6.4. REZULTATET PËR ÇDO FAKULTET/PROGRAM STUDIMI	17
6.5. PROBLEMATIKAT DHE REKOMANDIMET PËR PËRMIRËSIMIN E TREGUESVE TË ULËT PËR ÇDO FAKULTET/PROGRAM STUDIMI	23
6.5.1. REKOMANDIMET:	26
7. VLERËSIMET E PEDAGOGËVE	27
7.1. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME	27
7.2. RANKIMI I PEDAGOGËVE.....	28
7.3. REKOMANDIMET DHE PROPOZIMET PËR PËRMIRËSIMIN E TREGUESVE TË ULËT	28
8. ANEKSE	29
8.1. RANKIMET E FAKULTETEVE/PROGRAMEVE TË STUDIMIT	29
8.2. RANKIMI I PEDAGOGËVE	29
9. REZULTATET E ANKETIMIT “PAPER-BASED SURVEY” TË FIM.....	30
9.1. REZULTATET E ANKETIMIT	30
9.2. VLERËSIMI SIPAS PROGRAMEVE TË STUDIMIT.....	31
9.2.1. PROGRAMET E STUDIMIT PJESË E ANKETIMIT	31
9.2.2. PËRCAKTIMI I ANKETIMEVE TË PAVLEFSHME	31
9.3. KRITERET E VLERËSIMIT SIPAS FAKULTETIT/PROGRAMEVE TË STUDIMIT	31
9.4. REZULTATET E FIM / PROGRAMEVE TË STUDIMIT	32
9.5. PROBLEMATIKAT DHE REKOMANDIMET PËR PËRMIRËSIMIN E TREGUESVE TË ULËT PËR FAKULTETIN/PROGRAM STUDIMI	33
9.5.1. REKOMANDIMET	34
10. VLERËSIMET E PEDAGOGËVE NË FIM	35
10.1. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME	35
10.2. RANKIMI I PEDAGOGËVE.....	35
11. ANEKSE	36
11.1. RANKIMET E PROGRAMEVE TË STUDIMIT.....	36
11.2. RANKIMI I PEDAGOGËVE	36

1. Baza Ligjore

1.1. Ligji i Arsimit të Lartë

Procesi i Anketimit të studentëve është një proces i parashikuar në **Ligjin 80/2015, Kreu X, Neni 103 "Sigurimi i brendshëm i cilësisë"**, si një ndër masat në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies ku thuhet shprehimisht:

1. *Institucionet e arsimit të lartë janë përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë. ...*
2. *Njësia e sigurimit të cilësisë vlerëson, periodikisht, rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore-shkencore.*
3. *Në fund të çdo semestri apo para sezonit të provimeve, ajo organizon pyetësorin studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi.*
4. *Njësia e sigurimit të cilësisë realizon studime gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga institucioni i arsimit të lartë.*
6. *Raportet e vlerësimeve, të kryera nga njësitë për sigurimin e brendshëm të cilësisë së institucioneve të arsimit të lartë, përdoren si burim për vlerësimin e jashtëm dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.*

1.2. Kodi i Cilësisë së Arsimit të Lartë

Ky raport i referohet edhe standardeve dhe kriterëve për Sigurimin e Cilësisë së Brendshme, të përcaktuara në **VKM Nr.531, datë 11.9.2018 "Për Miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë"**, si përmbledhje e standardeve shtetërore për sigurimin e cilësisë.

- **SHTOJCA NR. 2,3,4 dhe 5: Standardet për sigurimin e cilësisë për programet e studimit të ciklit të parë Bachelor, ciklit të dytë "Master Profesional", ciklit të dytë "Master i Shkencave" dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave"**

"III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1 Institucioni ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit

Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.

Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.

Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.

Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies."

1.3. Akreditimi Institucional

Akreditimi i parë Institucional i Universitetit Politeknik të Tiranës është akredituar më Dt. 07.04.2017 me vendimin Nr. 13 të Bordit të Akreditimit. Raporti i Vlerësimit të Jashtëm u shoqërua me 9 Rekomandime. Për përmbushjen e 9 Rekomandimeve, Universiteti Politeknik i Tiranës ngriti një grup pune për hartimin e Planit të Veprimit.

Për përmbushjen e Rekomandimit Nr.1, "F3 – Vënia në funksionim e sistemit të sigurimit të brendshëm të cilësisë", Plani i Veprimit parashikon:

"P6-Sondazhi i studentëve"

Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (DSBC), në bashkëpunim me administratën e UPT merr masat për ngritjen e sistemit elektronik për kryerjen e sondazhit studentor. Ky sondazh hartohet në përmbyllje të çdo semestri, përpara fillimit të sesionit të provimeve. Përgatitja dhe vënia në funksionim e sistemit bëhet në periudhën Tetor – Dhjetor 2017.

Për herë të parë sondazhi do të aplikohet në Janar 2018. Mbi gjetjet do të hartohet raporti përkatës i cili do të përcillet në rektorat dhe në njësitë kryesore. Ky raport do të shërbejë si bazë për evidentimin e problematikave kryesore, me qëllim hartimin e planeve të veprimit për përmirësimin e tyre...

2. Organizimi i pyetësorit

Në përmbushje të detyrimeve që burojnë nga Ligj Nr. 80/2015, Neni 103, Pika 3 dhe sipas përcaktimeve të Planit të Veprimit, DSBC organizon Pyetësorit Studentor lidhur me cilësinë e mësimdhënies.

Për të garantuar pjesëmarrje dhe njohjen sa më të mirë me procesin, studentët u informuan përmes e-mail-it në lidhje me kohën e kryerjes së anketimit, mënyrën e plotësimit dhe rëndësinë e këtij procesi.

Nëpërmjet këtij pyetësori, çdo studenti ju dha mundësia të shprehë perceptimin e tij mbi procesin mësimor dhe personelin akademik si dhe të përcjellë pranë autoriteteve të Universitetit shqetësime specifike.

Plotësimi i pyetësorit bëhet për çdo lëndë dhe çdo pedagog që merr pjesë në procesin e mësimdhënies në semestrin aktual.

Plotësimi i pyetësorit filloi prej datës **12 Shkurt**, deri më **17 Shkurt 2019** nëpërmjet platformës online të sekretarisë mësimore: <http://bit-albania.com/upt.php>.

Me Urdhër të Rektorit **Nr.13, Datë 29.01.2019**, të gjitha sekretariatë mësimore përditësuan të dhënat mbi pedagogët në Sistemin Elektronik.

2.1. Avantazhet e Sistemit Elektronik

Realizimi i pyetësorit në mënyrë elektronike ka disa avantazhe:

1. Akses më të madh nga studentët duke pasur parasysh se pyetësori mund të plotësohej në çdo moment të ditës (brenda afateve të përcaktuara).
2. Angazhim të një numri të vogël punonjësish, krahasuar me zhvillim e pyetësorit në terren.
3. Kursim të kohës në përpunimin dhe analizimin e të dhënave.
4. Gjenerim të një morie të dhënash dhe analizash.
5. Kursim të mbi 35000 fletëve të formatit A4.
6. Reduktim të mundësinë e gabimit në përpunimin dhe interpretimin e të dhënave.

2.2. Qëllimi i Pyetësorit

Ky pyetësor ndihmon në krijimin e një panorame të problematikave në UPT, duke u fokusuar tek perceptimi i studentëve në lidhje me universitetin, fakultetin, programin e studimit ku ata studiojnë dhe pedagogët e tyre, për të mundësuar përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë akademike duke vazhduar traditën e ekselencës e duke konsoliduar reputacionin kombëtar e rajonal.

2.3. Hartimi i pyetjeve dhe Kriteret e vlerësimit

Për të përmbushur qëllimin e këtij Anketimi, u mendua që pyetjet të jenë të thjeshta për t'u kuptuar nga të gjithë. Bazuar në eksperiencën të ngjashme si dhe në konsultime me stafin e UPT, u arrit në hartimin e 9 pyetjeve:

- (P1) Informon në fillim të semestrit për përmbajtjen, objektivat dhe detyrimet e programit mësimor
 - (P2) Respekton vazhdimisht dhe me përpikmëri orarin mësimor
 - (P3) Është lehtësisht i kuptueshëm gjatë referimit / komunikimit në procesin mësimor
 - (P4) Sqaron aspektet teorike me shembuj praktike dhe/ose ilustrime të qarta
 - (P5) Përdor në mënyrë efektive mjete ndihmëse në procesin mësimor (dërrasën e zezë, video projektorin, etj.), sipas specifikës dhe natyrës së lëndës.
 - (P6) Rekomandon literaturë ndihmëse në lidhje me procesin mësimor
 - (P7) Komunikon dhe sillet brenda kuadrit etik
 - (P8) Është i gatshëm të ndihmojë studentët edhe përtej orës së mësimin
 - (P9) Nxit interesin dhe motivon studentët në lëndën përkatëse
-
- (Nota) E vlerësoj me NOTEN:
 - (Komenti)

Studenti ka të drejtën e vlerësimit të çdo pedagogu me pikë nga 1 deri në 5 për nëntë pyetjet e para, ku: 1 është vlerësimi më i ulët dhe 5 është vlerësimi më i lartë. Për një vlerësim më të përgjithshëm studenti vlerëson edhe me një notë e cila mund të ketë vlerën nga 1-10. Në fund, sipas dëshirës, studenti mund të japë edhe një vlerësim nëpërmjet një komenti me shkrim për pedagogun e lëndës.

3. Sistemi elektronik i pyetësorit

Për të krijuar një ide sa më të qartë të funksionimit të sistemit, hapat e ndjekur për plotësimin e pyetësorit, ilustrohen në vijim:

1. Hyjmë në faqen zyrtare të sekretarisë mësimore: <http://bit-albania.com/upt.php>. (fig.1)
2. Zgjedhim Universiteti Politeknik i Tiranës. (fig.1)
3. Zgjedhim Fakultetin ku studiojmë. (fig.2)
4. Me hyrjen në portal, zgjedhim opsionin “Anketim për Pedagogët”. (fig.3)
5. Ndiqen instruksionet e nevojshme për plotësimin e pyetësorit. (fig.4, fig.5, fig.6)
6. Pasi të plotësohet pyetësori, shtypim butonin “Prano të Gjitha Vlerësimet e Mëposhtme”. (fig.7)
7. Në qoftë se në ekran shfaqet mesazhi “KUJDES, nuk ju përgjigjet të gjitha pyetjeve”, atëherë duhet të kthehemi mbrapsht për të plotësuar të gjitha pyetjet. (fig.7)
8. Në qoftë se në ekran shfaqet mesazhi “Vlerësimet tuaja u memorizuan. Faleminderit për kontributin”, atëherë pyetësori është plotësuar me sukses. (fig.8)



Figura 1



Figura 2



Figura 3




Figura 4



Figura 5

bit-albania.com/upt.php

Search

- (P3) Eshtë lehtësish i **kuptueshëm** gjatë referimit / komunikimit në procesin mësimor
 1 2 3 4 5

- (P4) Sqaron aspektet teorike me **shembuj praktike** dhe/ose ilustrime të qarta
 1 2 3 4 5

- (P5) Përdor në mënyrë efektive **videoprojektorin** dhe/ose mjete të tjera ndihmëse në procesin mësimor
 1 2 3 4 5

- (P6) Rekomandon **literaturë** ndihmëse në lidhje me procesin mësimor
 1 2 3 4 5

- (P7) Komunikon dhe sillet brenda kuadrit **etik**
 1 2 3 4 5

- (P8) Eshtë i gatshëm të ndihmojë studentët edhe **përtej orës së mësim**
 1 2 3 4 5

- (P9) Nxit interesin dhe **motivon** studentët në lëndën përkatëse
 1 2 3 4 5

- (P10) E vlerësoj me **NOTEN:**
 1 2 3 4 5 6 7 8 9 10

- Nëse dëshironi komentoni (informacioni përcillet dhe trajtohet në mënyrë ANONIME)
Koment:
 Komentimi im

Figura 6

bit-albania.com/upt.php

Search

Sekretaria Mesimore
 Fakulteti i Inxhinierise Matematike & Fizike

DIL HYR

FIE FAU FIN FGJM FIMF FTI FIM

KUJDESI! Nuk ju përgjigjet të gjitha pyetjeve.

Figura 7



Figura 8

3.1. Gjenerimi i të dhënave

Pas përfundimit të anketimit, të dhënat e përfuara u eksportuan në format Excel, me këto informacione kryesore:

IDa	Fakulteti	Pedagogu	StMD5p2	Grupi	P1	P2	P3	P4	P5	P6	P7	P8	P9	Nota	Koment	Lenda
1782	XXX	XXX XXX	f5e27071836548cba4cbcd42e6badf84	XXXXXXXX	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	XXX XXX
17106	XXX	XXX XXX	adc0fc1a9ebee89a3d5b43e20198dcd	XXXXXXXX	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	XXX XXX
17107	XXX	XXX XXX	adc0fc1a9ebee89a3d5b43e20198dcd	XXXXXXXX	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	X	XXX XXX

Kolona e parë: Jep informacione në lidhje me kohën kur studenti ka plotësuar anketimin.

Kolona e dytë: Tregon fakultetin që ofron lëndën përkatëse për të cilën vlerësohet pedagogu.

Kolona e tretë: Emri i pedagogut.

Kolona e katërt: Paraqet në mënyrë të enkriptuar emrin e studentit që ka kryer anketimin. Në momentin që një student plotëson pyetësonin, emri i tij enkriptohet automatikisht (duke siguruar në këtë mënyrë anonimatit e plotë) dhe ky proces është i pakthyeshëm.

Kolona e pestë: Tregon grupin mësimor.

Kolona gjashtë - Kolona pesëmbëdhjetë: Tregojnë vlerësimin që ka marrë çdo pedagog për secilën pyetje.

Kolona gjashtëmbëdhjetë: Komenti i çdo studenti për pedagogun.

Kolona shtatëmbëdhjetë: Tregon lëndën që jep pedagogu përkatës.

Të dhënat e gjeneruara nga sistemi u studiuara dhe u bë pastrimi nga dublimet si dhe korrigjimi i emrave të pedagogëve tcilët kanë pasur lapsuse gjatë hedhjes nga sekretariteti mësimor.

3.2. Anonimati i studentit

Përgjigjet e pyetësorit ruhen dhe përpunohen në mënyrë **ANONIME** nga UPT dhe mbi bazën e tyre janë hartuar të dhëna statistikore për të evidentuar problematikat kryesore të perceptuara nga studentët. Në çdo rast, analiza e të dhënave të pyetësorit përcillet në fakultete pas përmbylljes së sesionit të provimeve, duke shmangur kështu çdo ndikim të mundshëm në vlerësimet përfundimtare.

4. Rezultatet e anketimit

4.1. Metodologjia e përdorur për analizimin e të dhënave

Mbi bazën e të dhënave të gjeneruara nga sistemi, u realizua një analizë statistikore në disa nivele:

- Nivel Institucioni
- Nivel Fakulteti
- Nivel Programesh Studimi
- Nivel Pedagogu

Në këtë mënyrë, u nxor për të gjitha nivelet e analizës mesatarja aritmetike për çdo pyetje nga P1 deri në P9, mesatarja aritmetike për vlerësimin me notë dhe sipas Formulës së Rankimit. Gjithashtu, për rezultatet në nivel Institucioni është llogaritur edhe moda dhe mediana, si tregues më të avancuar të trendit të përgjigjeve.

Formula e Rankimit është një instrument vlerësimi i përgjithshëm ku komponentë të ndryshëm kanë peshë të ndryshme në raport me vlerësimin e përgjithshëm të cilësisë. Gjithsesi, studenti bën një vlerësim me notë dhe vihet re që formula e propozuar dhe vlerësimi i përgjithshëm i studentit nuk kanë shmangie domethënëse.

Vlerësimi sipas formulës së rankimit është një vlerësim që del si rezultat i mesatares së ponderuar të 9 pyetjeve, ku secila nga këto të fundit shumëzohet me një koeficient që i referohet peshës së secilës pyetje në formulë.

- (P1) Informon në fillim të semestrit për përmbajtjen, objektivat dhe detyrimet e programit mësimor (X 5%)
- (P2) Respekton vazhdimisht dhe me përpikmëri orarin mësimor (X 20%)
- (P3) Është lehtësisht i kuptueshëm gjatë referimit / komunikimit në procesin mësimor (X 20%)
- (P4) Sqaron aspektet teorike me shembuj praktike dhe/ose ilustrime të qarta (X 5%)
- (P5) Përdor në mënyrë efikase mjete ndihmëse në procesin mësimor (dërrasën e zezë, video projektorin, etj.), sipas specifikës dhe natyrës së lëndës. (X 10%)
- (P6) Rekomandon literaturë ndihmëse në lidhje me procesin mësimor (X 10%)
- (P7) Komunikon dhe silllet brenda kuadrit etik (X 15%)
- (P8) Është i gatshëm të ndihmojë studentët edhe përtej orës së mësimi (X 5%)
- (P9) Nxit interesin dhe motivon studentët në lëndën përkatëse (X 10%)

Formula e Rankimit :

$$\text{Vlerësimi} = P1 \times 5\% + P2 \times 20\% + P3 \times 20\% + P4 \times 5\% + P5 \times 10\% + P6 \times 10\% + P7 \times 15\% + P8 \times 5\% + P9 \times 10\%$$

4.2. Pjesëmarrja në Anketim

Pas heqjes së dublimeve, numri i Anketimeve për të gjithë fakultetet pjesë e procesit të anketimit është **8429 ANKETIME**, të shpërndara nëpër Fakultetet përkatëse.


Sipas rregullave të anketimit, një student plotëson anketimin për lëndët që frekuenton si student i rregullt në këtë semestër. Studentët përsëritës nuk janë pjesë e anketimit, pasi ata kanë të drejtën e shprehjes nëpërmjet anketimit vetëm një herë, në momentin që e ndjekin lëndën për herë të parë.

Numri i studentëve pjesëmarrës në anketim për të gjitha Fakultetet është: **1213 STUDENTË**

NR.	FAKULTETI	NR I ANKETIMEVE	NR I STUDENTEVE PJESEMARRES	NR I STUDENTEVE/ FAKULTET	% E STUDENTEVE PJESEMARRES
1	Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës	2183	337	1582	21%
2	Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave	631	95	2237	4%
3	Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike	1609	200	1780	11%
4	Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike	438	83	890	9%
5	Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit	1359	176	2245	8%
6	Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit	2209	322	1769	18%
	TOTALI	8429	1213	10503	12%

Duhet të theksojmë faktin se numri total i studentëve për secilin Fakultet i referohet numrit të studentëve të raportuar nga sekretariatë mësimore në Janar 2019 dhe përfshin vetëm Programet e Studimit që janë të lidhura me Sistemin Elektronik.

5. Evidentimi i problematikave në rang Institucioni



Nga përpunimi i të dhënave në rang Institucioni është bërë një përmbledhje e vlerësimeve mesatare për secilën nga pyetjet si dhe për vlerësimet me notë (Grafiku i mësipërm). Gjithashtu, është bërë dhe analiza e vlerave të modës dhe medianës për të krijuar një ide më specifike mbi trendin e vlerësimit.

Duke u bazuar tek 9 pyetjet e anketimit, aspektet më problematik të evidentuar janë:

P6: Rekomandon literaturë ndihmëse në lidhje me procesin mësimor. 4.016

P9: Nxit interesin dhe motivon studentët në lëndën përkatëse. 4.067

Duke u bazuar në vlerat dhe rezultatet e mësipërme, pyetja P6 e cila lidhet me rekomandimin e literaturës ndihmëse është një problem i konstatuar edhe në Anketimin Studentor 2017-2018, Sem. II dhe si i tillë, DSBC rekomandon si prioritet marrjen e masave konkrete për sigurimin e literaturës ndihmëse për lëndët në çdo program studimi si dhe për informimin e studentëve mbi këtë literaturë në fillim të procesit mësimor. Literatura duhet të jetë e depozituar në Departamentet përkatëse dhe/ose në Bibliotekën Shkencore të UPT.

Gjithashtu, masa konkrete rekomandohet të merren në lidhje me përmirësimin e indikatorit P9, nëpërmjet organizimit të seminareve, trajnimeve dhe diskutimeve mes pedagogëve mbi metodologjitë e reja të mësimdhënies për të qenë më afër studentëve. Këto aktivitete duhet të bazohen në praktikat më të mira apo metodat e përdorura nga universitete prestigjioze.

6. Vlerësimet sipas Fakulteteve dhe Programeve të Studimit

6.1. Fakultetet pjesë e anketimit

Fakultetet pjesëmarrëse në anketim janë

1. Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës
2. Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit
3. Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike
4. Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave
5. Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit
6. Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike

Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike e ka zhvilluar anketimin përmes pyetësorëve të printuar për shkak të pamundësisë së aplikimit të sistemit elektronik. Për këtë arsye, të dhënat për këtë fakultet dhe rezultate e përfuara janë trajtuar më vete në kapitujt 9-10-11 të këtij raporti.

6.2. Programet e Studimit pjesë e anketimit

Nga analiza e të dhënave paraprake, janë evidentuar 41 Programe Studimi të cilat kanë qenë pjesë e këtij anketimi. Për periudhën që është zhvilluar anketimi, numri i Programeve të Studimit aktive ka qenë 49, por disa Programe Studimi nuk kanë qenë pjesë e sistemit Elektronik.

Tabela në vijim tregon Programet e Studimit sipas fakulteteve përkatëse të cilët janë bërë pjesë e anketimit:

41 Programe Studimi

	Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës	NR I ANKETIMEVE
PROGRAMET E STUDIMIT	Arkitekturë	1479
	Urbanistikë	704
	Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave	NR I ANKETIMEVE
PROGRAMET E STUDIMIT	INXHINIERI GJEOBURIME	76
	INXHINIERI GJEOBURIME (Profili Gjeoinxhinieri)	14
	INXHINIERI GJEOBURIME (Profili Inxhinieri e Naftës Gazit dhe	8
	INXHINIERI GJEOMFORMATIKE	219
	INXHINIERI GJEOMJEDISI	63
	M SH BURIMET E ENERGIJË	44
	M SH GJEOMATIKE	15
	M SH GJEOMJEDISI	1
	SHKENCAT E TOKES	191
	Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike	NR I ANKETIMEVE
PROGRAMET E STUDIMIT	Elektrike Automatizim Industrie	630
	Elektrike Energjetikë	596
	M P Automatizim Industrie	17
	M P Mekatronikë	21
	M SH Automatizim Industrie	51
	M SH Energjetikë	24
	Mekatronikë	270
	Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike	NR I ANKETIMEVE
PROGRAMET E STUDIMIT	Inxhinieri Fizike	100
	Inxhinieri Matematike	224
	M P Inxhinieri Fizike në Mjekësi	3
	M P Inxhinieri Matematike në Aktuaristikë	4
	M P Inxhinieri Matematike në Analiza Sistemesh	60
	M SH Inxhinieri Fizike	26
	M SH Inxhinieri Matematike	21
	Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit	NR I ANKETIMEVE
PROGRAMET E STUDIMIT	Gjeodezi	101
	Hidroteknikë	42
	M P Inxhinieri Mjedisi	9
	Mjedisi	236
	MSH Energjetikë	29
	MSH Gjeodezi	8
	MSH Hidroteknikë	256
	MSH Strukturist	132
	MSH Trajtim Uji	26
	Ndërtim	520
	Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit	NR I ANKETIMEVE
PROGRAMET E STUDIMIT	Inxhinieri Elektronike	328
	Inxhinieri Informatike	1043
	Inxhinieri Telekomunikacioni	651
	Master Shkencor Ing Elektronike	38
	Master Shkencor Ing Informatike	59
	Master Shkencor Ing Telekomunikacion	90

Shënim: Emërtimet e Programe të Studimit, në këtë tabelë dhe në vijim, janë paraqitur sipas mënyrës së regjistrimit të tyre një sistemin elektronik të Sekretarisë Mësimore.

6.2.1.Përcaktimi i anketimeve të pavlefshme

Për të përcaktuar numrin e anketimeve të cilat nuk përbëjnë statistike, nisemi nga fakti se një student është anketuar mesatarisht rreth 7 herë për pedagogët e tij. Duke marrë në konsideratë që një Program Studimi duhet të ketë një numër minimal studentësh pjesëmarrës, atëherë rezultatet e vjela do të quhen të vlefshme në ato Programe Studimi të cilat kanë një numër anketimesh më të madh se 60.

Nga sa më lart, rezultatet në vijim të këtij raporti nuk përfshijnë 20 Programe Studimi me numër të ulët anketimesh. Programet e pa përfshira janë:

REZULTATE JO PJESE E RANKIMIT			
NR.	FAKULTETI	PROGRAMI I STUDIMIT	NR. ANKETIMEVE
1	FTI	Master Shkencor Ing Informatike	59
2	FIE	M SH Automatizim Industrie	51
3	FGJM	M SH BURIMET E ENERGIJE	44
4	FIN	Hidroteknikë	42
5	FTI	Master Shkencor Ing Elektronike	38
6	FIN	MSH Energjetikë	29
7	FIMIF	M SH Inxhinieri Fizike	26
8	FIN	MSH Trajtim Uji	26
9	FIE	M SH Energjetikë	24
10	FIE	M P Mekatronikë	21
11	FIMIF	M SH Inxhinieri Matematike	21
12	FIE	M P Automatizim Industrie	17
13	FGJM	M SH GJEOMATIKE	15
14	FGJM	INXHINIERI GJEOBURIME (Profili Gjeoinxhinieri)	14
15	FIN	M P Inxhinieri Mjedisi	9
16	FGJM	INXHINIERI GJEOBURIME (Profili Inxhinieri e Naftës Gazit dh	8
17	FIN	MSH Gjeodezi	8
18	FIMIF	M P Inxhinieri Matematike në Aktuaristikë	4
19	FIMIF	M P Inxhinieri Fizike në Mjekësi	3
20	FGJM	M SH GJEOMJEDIS	1

6.3. Kriteret e vlerësimit sipas Fakulteteve/Programeve të Studimit

Perceptimi që kanë studentët për performancën e Fakulteteve dhe Programeve të studimit për çdo Fakultet, bazuar në vlerësimin e tyre, është paraqitur në Pikën 6.4 të këtij raporti.


Duke u bazuar në kriteret e mëposhtme dhe në rezultatet e Pikës 6.4, është bërë një evidentim i problematikave për çdo Fakultet dhe për çdo Program Studimi të cilat rezultojnë poshtë vlerave të paraqitura në vijim:

- Vlerësimi mesatar minimal i pyetjeve 3.75 (Për vlerësimin e pyetjeve 1 deri në 9).
- Dy vlerësimet e më të ulëta për çdo Fakultet/Program Studimi.

6.4. Rezultatet për çdo Fakultet/Program Studimi


- FAKULTETI I ARKITEKTURËS DHE URBANISTIKËS**

NR.	PYETJET SIPAS PYETESORIT	VLERESIMI	EVOLUIMI I TREGUESIT NE LIDHJE ME SONDAZHIN E MEPARSHEM
P1	Informon në fillim të semestrit për përmbajtjen, objektivat dhe detyrimet e programit mësimor.	4.328	▼
P2	Respekton vazhdimisht dhe me përpikmëri orarin mësimor.	4.309	▼
P3	Eshtë lehtësisht i kuptueshëm gjatë referimit / komunikimit në procesin mësimor.	4.197	▼
P4	Sqaron aspektet teorike me shembuj praktike dhe/ose ilustrime të qarta.	4.190	▼
P5	Përdor në mënyrë efektive mjete ndihmëse në procesin mësimor (dërrasën e zezë, video projektorin, etj), sipas Rekomandon literaturë ndihmëse në lidhje me procesin mësimor.	4.172	▲
P6	Komunikon dhe sillet brenda kuadrit etik.	3.962	▼
P7	Eshtë i gatshëm të ndihmojë studentët edhe përtej orës së mësimi.	4.056	▼
P9	Nxit interesin dhe motivon studentët në lëndën përkatëse.	4.044	▼
	Formula e Rankimit (Mes. e UPT 4.274)	4.237	▼
	Nota (Mes. e UPT 8.298)	8.162	▼
	NUMRI I ANKETIMEVE	2183	



• **FAKULTETI I GJEOLGJISË DHE MINIERAVE**


NR	PYETJET SIPAS PYETESORIT	VLERESIMI	EVOLUIMI I TREGUESIT NE LIDHJE ME SONDAZHIN E MEPARSHEM
P1	Informon në fillim të semestrit për përmbajtjen, objektivat dhe detyrimet e programit mësimor.	4.345	▼
P2	Respekton vazhdimisht dhe me përpikmëri orarin mësimor.	4.298	▼
P3	Eshtë lehtësisht i kuptueshëm gjatë referimit / komunikimit në procesin mësimor.	4.155	▼
P4	Sqaron aspektet teorike me shembuj praktike dhe/ose ilustrime të qarta.	4.230	▼
P5	Përdor në mënyrë efektive mjete ndihmëse në procesin mësimor (dërrasën e zezë, video projektorin, etj), sipas	4.249	▼
P6	Rekomandon literaturë ndihmëse në lidhje me procesin mësimor.	4.071	▼
P7	Komunikon dhe sillet brenda kuadrit etik.	4.390	▼
P8	Eshtë i gatshëm të ndihmojë studentët edhe përtej orës së mësimin.	4.168	▼
P9	Nxit interesin dhe motivon studentët në lëndën përkatëse.	4.052	▼
	Formula e Rankimit (Mes. e UPT 4.274)	4.224	▼
	Nota (Mes. e UPT 8.298)	8.092	▼
	NUMRI I ANKETIMEVE	631	



NR	PROGRAMI I STUDIMIT	P1	P2	P3	P4	P5	P6	P7	P8	P9	VLERESIMI SIPAS RANKIMIT	NOTA MESATARE	NR ANKETIMEVE
1	INXHINIERI GJEONFORMATIKE	4.187	4.142	3.845	3.900	3.922	3.758	4.237	3.932	3.671	3.969	7.502	219
2	SHKENCAT E TOKES	4.094	4.000	3.921	4.063	4.115	3.869	4.188	3.984	3.895	4.008	7.466	191
3	INXHINIERI GJEORURIME	4.750	4.737	4.711	4.724	4.724	4.461	4.763	4.447	4.513	4.670	9.250	76
4	INXHINIERI GJEOMJEDISI	4.540	4.524	4.444	4.587	4.508	4.365	4.556	4.429	4.317	4.474	8.873	63

• **FAKULTETI I INXHINIERISË ELEKTRIKE**


NR.	PYETJET SIPAS PYETESORIT	VLERESIMI	EVOLUIMI I TREGUESIT NE LIDHJE ME SONDAZHIN E MEPARSHEM
P1	Informon në fillim të semestrit për përmbajtjen, objektivat dhe detyrimet e programit mësimor.	4.440	▲
P2	Respekton vazhdimisht dhe me përpikmëri orarin mësimor.	4.484	▲
P3	Eshtë lehtësisht i kuptueshëm gjatë referimit / komunikimit në procesin mësimor.	4.206	▲
P4	Sqaron aspektet teorike me shembuj praktike dhe/ose ilustrime të qarta.	4.319	▲
P5	Përdor në mënyrë efikase mjete ndihmëse në procesin mësimor (dërrasën e zezë, video projektorin, etj), sipas	4.332	▲
P6	Rekomandon literaturë ndihmëse në lidhje me procesin mësimor.	4.101	▼
P7	Komunikon dhe sillet brenda kuadrit etik.	4.613	▲
P8	Eshtë i gatshëm të ndihmojë studentët edhe përtej orës së mësimi.	4.273	▲
P9	Nxit interesin dhe motivon studentët në lëndën përkatëse.	4.146	▲
	Formula e Rankimit (Mes. e UPT 4.274)	4.340	▲
	Nota (Mes. e UPT 8.298)	8.432	▲
	NUMRI I ANKETIMEVE	1609	



NR	PROGRAMI I STUDIMIT	P1	P2	P3	P4	P5	P6	P7	P8	P9	VLERESIMI SIPAS RANKIMIT	NOTA MESATARE	NR. ANKETIMEVE
1	Elektrike Automatizim Industrie	4.475	4.524	4.181	4.310	4.373	4.054	4.575	4.214	4.105	4.330	8.395	630
2	Elektrike Energjetike	4.403	4.492	4.275	4.381	4.361	4.183	4.653	4.307	4.235	4.384	8.522	596
3	Mekatronikë	4.363	4.370	4.033	4.081	4.096	3.900	4.530	4.211	3.933	4.186	8.122	270

- FAKULTETI I INXHINIERISË MATEMATIKE DHE INXHINIERISË FIZIKËS**


NR.	PYETJET SIPAS PYETESORIT	VLERESIMI	EVOLUIMI I TREGUESIT NE LIDHJE ME SONDAZHIN E MËPARSHËM
P1	Informon në fillim të semestrit për përmbajtjen, objektivat dhe detyrimet e programit mësimor.	4.534	▼
P2	Respekton vazhdimisht dhe me përpikmëri orarin mësimor.	4.466	▼
P3	Eshtë lehtësisht i kuptueshëm gjatë referimit / komunikimit në procesin mësimor.	4.295	▼
P4	Sqaron aspektet teorike me shembuj praktike dhe/ose ilustrime të qarta.	4.381	▼
P5	Përdor në mënyrë efikase mjete ndihmëse në procesin mësimor (dërrasën e zezë, video projektorin, etj), sipas Rekomandon literaturë ndihmëse në lidhje me procesin mësimor.	4.349	▼
P6	Komunikon dhe sillet brenda kuadrit etik.	4.279	▲
P7	Eshtë i gatshëm të ndihmojë studentët edhe përtej orës së mësimi.	4.269	▼
P9	Nxit interesin dhe motivon studentët në lëndën përkatëse.	4.258	▼
	Formula e Rankimit (Mes. e UPT 4.274)	4.399	▼
	Nota (Mes. e UPT 8.298)	8.623	▼
NUMRI I ANKETIMEVE		438	



NR.	PROGRAMI I STUDIMIT	P1	P2	P3	P4	P5	P6	P7	P8	P9	VLERESIMI SIPAS RANKIMIT	NOTA MESATARE	NR. ANKETIMEVE
1	Inxhinieri Matematike	4.491	4.438	4.304	4.357	4.205	4.147	4.585	4.174	4.263	4.349	8.670	224
2	Inxhinieri Fizike	4.440	4.550	4.180	4.400	4.400	4.350	4.730	4.290	4.190	4.406	8.400	100
3	M P Inxhinieri Matematike në Analiza Sistemesh	4.650	4.300	4.267	4.333	4.600	4.567	4.650	4.317	4.250	4.418	8.700	60

• **FAKULTETI I INXHINIERISË SË NDËRTIMIT**


NR.	PYETJET SIPAS PYETESORIT	VLERESIMI	EVOLUIMI I TREGUESIT NE LIDHJE ME SONDAZHIN E MËPARSHEM
P1	Informon në fillim të semestrit për përmbajtjen, objektivat dhe detyrimet e programit mësimor.	4.301	▼
P2	Respekton vazhdimisht dhe me përpikmëri orarin mësimor.	4.361	▼
P3	Eshtë lehtësisht i kuptueshëm gjatë referimit / komunikimit në procesin mësimor.	4.056	▼
P4	Sqaron aspektet teorike me shembuj praktike dhe/ose ilustrime të qarta.	4.123	▼
P5	Përdor në mënyrë efikase mjete ndihmëse në procesin mësimor (dërrasën e zezë, video projektorin, etj), sipas Rekomandon literaturë ndihmëse në lidhje me procesin mësimor.	4.043	▲
